



OFFICE OF THE COMPLIANCE ADVISOR OMBUDSMAN  
FOR INTERNATIONAL FINANCE CORPORATION (IFC) AND MULTILATERAL  
INVESTMENT GUARANTEE AGENCY (MIGA) MEMBERS OF THE WORLD BANK GROUP  
2121 PENNSYLVANIA AVENUE, NW • WASHINGTON, DC 20433, USA  
TELEPHONE (202) 458-9452 • FACSIMILE (202) 522-7400  
E-MAIL: [cao@worldbankgroup.org](mailto:cao@worldbankgroup.org) • INTERNET: [WWW.CAO-OMBUDSMAN.ORG](http://WWW.CAO-OMBUDSMAN.ORG)

## **RAPORT PROGRESIV NGA CAO SHQIPËRI – ANKESA PËR BANKERS PETROLEUM Shtator 2016**

### **Informacion i përditësuar mbi statusin e lidhjes së sizmometrave dhe transmetimin e të dhënave**

Në përgjigje të drejtpërdrejtë të shqetësimeve të komunitetit, Bankers, në konsultim me Institutin e Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) bleu dy sizmometra dhe u angazhua për instalimin e tyre për të mundësuar përmirësimin e monitorimit kombëtar sizmologjik si dhe për të pasur një tablo më të qartë për zonën e Patos-Marinzës.

Në vijim të fillimit të procesit të dialogut, dy sizmometrat u instaluan në vendet e përcaktuara nga ekspertët përkatës. Ky proces u vijua nga një letër e përbashkët e Grupit të Dialogut drejtuar zyrtarëve të lartë të qeverisë, ku kërkohej qartësi në lidhje me operimin e sizmometrave dhe transmetimin e të dhënave sizmike në rrjetin kombëtar.

Marrëveshja për monitorimin dhe mirëmbajtjen e sizmometrave u firmos nga BPAL dhe institucionet shtetërore përkatëse, edhe si rezultat i përpjekjeve të pjesëmarrësve në procesin e dialogut. Dy sizmometrat u lidhën në shtator 2016 me rrjetin kombëtar sizmik dhe të dhënat po merren nga IGJEUM.

Analizimi dhe interpretimi i të dhënave është përgjegjësi e IGJEUM. Të dhënat do të përdoren gjithashtu nga një ekspert ndërkombëtar i identifikuar, dhe rënë dakord nga të gjitha palët në Grupin e Dialogut. Palët janë në pritje të një takimi të Grupit të Dialogut për të rishikuar dhe diskutuar mbi informacionit rigoroz shkencor si rezultat i kësaj pune.